



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MANUSHAQE H. JAUPI
ADRESA NR.2, GEORGE W. BUSH,
NR.13
TEL: 692768887

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 840

Nr. koleksioni: 167

Tirane më 01/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë



A2021051340019216106



A2021051340019216106

KONTRATE PER SHITBLERJEN E KUOTAVE TE SHOQERISE**INTROVUS SOLUTIONS SH.P.K.**

Sot, më date 01.02.2021 para meje Notere MANUSHAQE H. JAUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NR.2, GEORGE W. BUSH, NR.13, u paraqitën personalisht:

SHITES:

Redi Haxhi, atësia Bashkim, amësia Burbuqe, shtetas Shqiptar, lindur në Bilisht, Devoll dhe banues në TIRANË, me adresë Dom Mark Dushi; Nd. 48; H. 8; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 20/05/1977, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036445168 dhe nr. personal H70520137F, i cili zotëron 75% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë Introvus Solutions sh.p.k, *(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si Shitës).*

E pranishme : Griselda Haxhi, atësia Vasili, amësia Kristina, shtetase Shqiptare, lindur në Kuçovë, Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Dom Mark Dushi; Nd. 48; H. 8; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 26/08/1980, gjendja civile e martua, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033562583 dhe nr. personal I05826106B, ne cilesinë e bashkëshortes se Shitesit;

dhe

BLERES:

Ermal Sallaku, atësia Alfred, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Ferit Xhajko Nr. 79/9; Njësia Administrative Nr. 8; 0000; Tiranë, lindur më 25/09/1986, gjendja civile beqar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 024616465 dhe nr. personal I60925040K, i cili zotëron 25% te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë Introvus Solutions sh.p.k, *(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si Blerës).*

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705 e vijues i tij, ligji nr. 110/2018 "Për Noterinë", Udhëzimit nr. 232, datë 14.1.2016 "Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Shitjes Pasuri e Luajtshme - **Kuotave te Shoqerise Introvus Solutions shpk**, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore, si më poshtë vijon

Duke qenë se:

Shoqeria Introvus Solutions sh.p.k. është themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, identifikuar me NUIS L91323013Q, (Shoqeria) me kapital të regjistruar prej 10,000 (dhjete mijë) Leke, i ndare në 2 (dy) kuota, të cilat zotërohet në masën 75% (7,500 Leke) nga ortakët Z.Redi Haxhi dhe 25% (2,500 Leke) nga ortakët Z.Ermal Sallaku.



A2021051340019216106

Ortaku Z.Redri Haxhi deshiron te shese teresisht kuoten (75%) qe zoteron ne kapitalin e shoqerise Introvus Solutions sh.p.k. (Kuota ne Shitje) dhe ka njoftuar Ortakun tjetër per kete qellim.

Ortaku tjetër, Z.Ermal Sallaku, deshiron te bleje Kuoten ne Shitje dhe ka njoftuar Z.Redri Haxhi per ushtrimin e se drejtes se parablerjes se kuotes referuar Nenit 6 paragrafi 6.3 i Statutit te shoqerise Introvus Solutions sh.p.k. miratuar me date 14.04.2020.

Bashkeshortja e Shitesit jep pelqimin e saj te lire dhe te pavesuar per shitjen e kuotes qe Shitesi zoteron ne kapitalin e shoqerise Introvus Solutions sh.p.k, ne kushtet qe Shitesi e ka themeluar Shoqerine tregtare gjate kohezgjatjes se martesës dhe kjo veprimtari tregtare ben pjese ne regjimin pasuror martesor te bashkesise ligjore.

Atehere:

Palet bien dakord per nenshkrimin e kesaj Kontrate per shitblerjen e kuotes se kapitalit te Shoqerise, ketu e me poshte referuar si "Kontrata", me kushtet dhe permbajtjen si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti i Kontrates

Objekt i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise se kuotes se zoteruar nga Shitesi, nepermjet shitjes se saj te Bleresit, si me poshte:

Shitesi Z.Redri Haxhi, i shet Bleresit Z.Ermal Sallaku kuoten qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise me vlere nominale 7,500 (shtate mije e peseqind) Leke, e cila perfaqeson 75% te kapitalit te shoqerise Introvus Solutions sh.p.k.

Neni 2

Çmimi i shitjes dhe menyra e pageses

Çmimi i Kuotes ne Shitje qe do te paguhet nga Bleresi dhe perfaqeson vleren nominale te Kuotes ne Shitje eshte 7,500 (shtatemije e peseqind) Leke.

Pagesa e Çmimit te shitjes, sipas pikes 2.1 me siper te ketij neni, do te paguhet nga Bleresi ne llogarine bankare te Shitesi brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike nga data e nenshkrimit te Kontrates.

Neni 3

Transferimi i Pronesise

Pronesia mbi kuoten sipas kesaj Kontrate, transferohet nga Shitesi tek Bleresi, ne momentin e nenshkrimit te Kontrates.

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi zhvishet nga te drejatat dhe detyrimet qe rrjedhin nga pronesia mbi kuoten e transferuar dhe keto te drejta e detyrime kalojne tek Bleresi, ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate, legjislacionin ne fuqi dhe Statutin e Shoqerise.

Shitesi do te siguroje qe kjo Kontrate te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit brenda 30 ditesh kalendarike nga data e nenshkrimit te Kontrates.



A2021051340019216106

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

Shitesi deklaron dhe garanton ndaj Bleresit, se secila nga garancite dhe deklarimet (“Garancite e Shitesit”) ne vijim jane te verteta dhe te sakta.

Shitesi gezon te gjitha te drejtat dhe aftesite ligjore per te lidhur kete Kontrate dhe per te perfunduar transakcionet per te cilat eshte rene dakord ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.

Kuota ne Shitje eshte e ngarkuar me Barre. Mbi Kuoten ne Shitje ekziston nje Opsion Blerje i krijuar per nje afat 5 vjecar, perkatesisht nga data 04.02.2019 deri ne daten 04.02.2024. Shitesi ka informuar Bleresin mbi gjendjen e Kuotes ne Shitje, dhe Bleresi deklaron se ka marre dijeni te plote per barret apo te detyrimet e tjera qe rendojne mbi Kuoten ne Shitje dhe do te respektoje te gjitha te drejtat e treteve mbi Kuoten ne Shitje. Pra, Bleresi eshte informuar se:

Ekziston nje marreveshje me shkrim per te vendosur Barre mbi Kuoten ne Shitje. Kuota eshte e ngarkuar me te drejten e Opsionit te Blerjes. Me perjashtim te ketyre Kontratave/Marreveshjeve te permendura ne kete dispozite, nuk ekziston asnje kontrate, marreveshje, veprim juridik me shkrim apo me goje, me kusht ose jo me te trete, objekt i se ciles eshte krijimi, kalimi, shitja, blerja, parablerja, vendosja e ndonje Barre apo opsioni per te blere apo shitur Kuoten ne Shoqeri apo per te konvertuar borxhin e te treteve ne kuota ne Shoqeri.

Shitesi detyrohet te demshperblejne Bleresin apo Shoqerine, ne cdo kohe si pasoje e:

ngjarjeve, rrethanave apo fakteve te cilat kane lindur, ndodhur apo vertetuar perpara nenshkrimet te kontrates se shitjes; ose

ngjarjeve, rrethanave apo fakteve qe kane lidhje me veprime apo mosveprime te Shitesit, perpara nenshkrimet te kontrates se shitjes.

Neni 5

Gjendja perfundimtare e kuotave te Shoqerise

Pas transferimit te pronesise, sipas kesaj Kontrate, gjendja e pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin e Shoqerise Introvus Solutions sh.p.k. do te jete:

Z.Ermal Sallaku eshte ortak i vetem i shoqerise Introvus Solutions sh.p.k., zoterues i kuotes me vlere 10,000 (dhjete mije) Leke, qe perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise.

Neni 6

Deklarimet e garancite se Bleresit

Bleresi garanton se gezon te gjitha te drejtat dhe aftesite ligjore per te lidhur kete Kontrate dhe per te perfunduar transakcionet per te cilat eshte rene dakord ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

Bleresi garanton se do te permbush te gjitha detyrimet e tij sipas permbajtjes se kesaj Kontrate.

Bleresi pranon se perpara nenshkrimet te Kontrates i jane dhene mundesi te plota per te marre informacionin e nevojshem ne lidhje me Shoqerine/Kuoten ne Shitje ne menyre qe te marre nje vendim te informuar ne lidhje me kete transakcion.

Neni 7



Kostot

7.1 Secila Pale merr persiper kostot e saj lidhur me negociaten, mbylljen dhe nenshkrimin e dokumentave te detyrueshme ligjerisht ose sipas kontratave per shitjen e Kuotes ne Shitje.

7.2 Cdo tarife, takse ose tatim qe duhet paguar nese ka te tille si rezultat i nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe i kalimit te Kuotes ne Shitje, merret persiper nga pala Blerese.

Neni 8

Pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe anti-korrupsioni

Shitesi eshte i perkushtuar te kryeje aktivitetet e biznesit ne menyre te drejte, te ndershme dhe transparente ne perputhje me ligjet e zbatueshme kunder korrupsionit, pastrimit te parave, financimit te terrorizmit dhe ligjet e tjera te zbatueshme ne Republiken e Shqiperise, dhe ne kete drejtim Bleresi konfirmon qe nuk ka dhene, premtuar, marre ose pranuar ndonje pagese monetare ose lloje te tjera te fitimeve dhe perfitimeve te fituara ne menyre te paligjshme ne lidhje me negociatat dhe/ose perfundimin e kesaj Kontrate.

Shitesi kundershton çdo lloj praktike korruptive, perfshire, por pa u kufizuar ne rryshfet, pastrim parash, blerje ose ofrim te ndonje fitimi tjetër ose sigurimit te avantazheve te paligjshem dhe/ose qe shkelin parimet e pergjithshme te etikes se biznesit, ne menyre qe te fitohet nje avantazh ose perfitim i papershtatshem per te marre ose mbajtur nje biznes ose per te siguruar nje ndikim te kunderligjshem nga çdo nepunes civil, punonjes ose menaxher ne institucionet shteterore, partite politike ose pjesemarrjet e tyre perkatese ose ndonje kompani, organizate ose pale e treta. Ndermarrja e çdo lloj veprimtarie korruptive nga Bleresi, direkt ose permes paleve te treta, do te konsiderohet nje shkelje serioze e kesaj Kontrate.

Shkelja e dispozitave te ketij neni i jep Shitesit nje te drejte te pakthyeshme per te nderprere vlefshmerine e kesaj Kontrate me nje efekt te menjehershem duke derguar nje njoftim me shkrim kur nje shkelje e tille perben nje baze te vlefshme per te kerkuar ndonje kosto shtese dhe/ose deme te shkaktuara kundrejt Shitesit ose reputacionit te tij te biznesit per shkeljen e parimeve antikorrupsion nga Bleresi.

Neni 9

Informacione konfidenciale

Termi "Informacion Konfidencial" do te thote te gjitha informacionet e nje natyre konfidenciale, pronesore ose sekrete te shpalosura per palet ose te marra ndryshe nga palet ne lidhje me kete Kontrate, dhe qe kane te bejne me organizaten, punonjesit, kushtet financiare ose planet e biznesit te paleve, klienteve, procedurave, planeve, pervojës operative, filialeve ose bashkepunetoreve te saj, etj.

Ne masen qe, ne lidhje me Kontraten, Shitesi disponon informacionin ne lidhje me Bleresin qe eshte caktuar nga pala si konfidencial ose eshte nga natyra e tij qartesisht konfidencial (ketu e tutje "Informacioni Konfidencial"), Shitesi merr persiper te ruaje konfidencialitetin e informacionit dhe te mos zbuloje informacionin konfidencial ndaj paleve te treta pa pelqimin e Bleresit. Ne qofte se nuk percaktohet ndryshe ne ligjet e detyrueshme lokale ose standardet profesionale, detyrimi i konfidencialitetit te permendur ne kete nen nuk do te zbatohet per informacionin qe;



A2021051340019216106

Eshte apo do te behej i disponueshem publikisht (duke perfshire, pa kufizim, çdo informacion te dorezuar ne çdo agjenci qeveritare dhe te disponueshem per publikun), perveçse kur eshte si rezultat i shkeljes se detyrimit te konfidencialitetit nga Shitesi; ose

Behet i disponueshem per Shitesin nga nje pale e trete pa patur ne thelb te njejtat kufizime te specifikuara ketu; ose

Behet i disponueshem per Shitesin ne menyre jo-konfidenciale nga nje burim i ndryshem nga Bleresi, qe Shitesi ne menyre te arsyeshme beson se nuk eshte i ndaluar tja zbuloje keto te dhena paleve te treta per shkak te nje detyrimi ndaj Bleresit; ose

Eshte i njohur nga Shitesi perpara marrjes se tij nga Bleresi, pa asnje detyrim konfidencialiteti ne lidhje me to.

Palet njohin dhe pranojne qe secila prej tyre ka te drejte te beje publik Informacionin Konfidencial kur kjo kerkohet nga ligji apo ne perputhje me ligjin ne fuqi, nga gjykata, autoritet qeveritare, rregullatore apo autoritete te tjera perkatese. Dhenia e ketij informacioni nuk do te konsiderohet si shkelje e detyrimeve te konfidencialitetit nga ana e Pales qe e zbulon ate. Vetem nese ndalohet nga legjislacioni ne fuqi, Pala qe zbulon informacionin duhet te beje çdo perpjekje te arsyeshme per te njoftuar Palen tjeter paraprakisht per nje zbulim te tille dhe duhet t'i ofroje Pales tjeter, asistencen e duhur qe mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme, qe kjo Pale te mund te nderhyje dhe ndaloje zbulimin e informacionit, nese eshte e pershtatshme.

Ne rast te mosnjoftimit paraprak, Pala qe zbulon informacionin, do te informoje Palen tjeter rreth zbulimit te informacionit menjehere pas zbulimit te tij, perveçse kur ndalohet nga ligji ne fuqi.

Gjate kohezgjatjes se kontrates dhe per nje periudhe te pakufizuar pas kesaj, palet do te mbajne sekret te gjithë informacionin konfidencial dhe do te zbatojne procedura te tilla te sigurise qe mund te jene te nevojshme per te ruajtur sekretin e informacionit konfidencial.

Neni 10

Forca Madhore

Mospermbushja e kesaj kontrate, nga ana e njerës prej paleve, nuk do te konsiderohet si shkelje e kesaj kontrate per sa kohe kjo mospermbushje vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar Force Madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dha afatet e kesaj marreveshjeje dhe (b) ka informuar palen tjeter ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje. Force Madhore do te konsiderohet cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise, e shpallur ne formen e ligjit apo ne tjeter menyre, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire, kryengritje popullore, lufte (e deklaruar ose jo), aksione terroriste ose guerrilase te grupeve apo te individeve te vecante, greva apo shqetesime te tjera te punes te kesaj natyre, zjarre, termete, epidemi, pandemi, apo cdo lloj shkakut tjeter, qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre dhe qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin.

Cdo periudhe kohe, brenda se ciles njera prej paleve, bazuar ne kete Kontrate, do te ndermarre ndonje veprim, do te zgjatet ne menyre te barabarte me periudhen e kohes ne te cilen pala e kishte te pamundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore. Ne rastin kur ngjarjet e Forces Madhore zgjasin per me shume se 3 muaj rresht, Palet do te jene te lira te zgjidhin ne menyre te njeanshme, pa asnje penalitet, kete Kontrate.

Neni 11



A2021051340019216106

Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve

Kjo Kontrate, perfshire anekset e saj dhe te gjitha faktet e lidhura, do te qeveriset dhe interpretohet ne perputhje me ligjin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise. Cdo veprim juridik ose procedure qe lind nen ose ne lidhje me Kontraten ose sherbimet do t'i referohet dhe mbahet para gjykatave kompetente te Republikes se Shqiperise.

Palet bien dakord te perdorin perpjekjet e tyre per te zgjidhur me negociata, me mirebesim dhe pa vonese te panevojshme, çdo mosmarreveshje ose pretendim qe lind nen ose ne lidhje me kete Kontrate. Nese nje mosmarreveshje ose kerkese nuk zgjidhet brenda 30 diteve nga paraqitja e nje mosmarreveshje / pretendimi te tille Pales tjeter Kontraktuese per negociim, secila Pale Kontraktuese do te autorizohet te paraqese mosmarreveshjen para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per zgjidhje. Asgje e specifikuar ne kete paragraf nuk do te ndaloje asnje nga Palet Kontraktuese te filloje procedurat gjyqesore ne lidhje me mbrojtjen e te drejtave te pronesise intelektuale, sekretet e biznesit, ose informacionin konfidencial ose ruajtjen e ndonje te drejte ligjore ose mjete juridike ne dispozicion ne çdo kohe para ose pas fillimit te zgjidhjes se mosmarreveshjeve pajtuese.

Neni 12

Titujt

Titujt dhe titujt e seksioneve ne kete Kontrate kane per qellim vetem lehtesine e references dhe nuk synojne dhe nuk do te interpretohen per te shpjeguar, modifikuar ose vendosur ndonje rregullim ne cilindo dispozite te kesaj Kontrate. Interpretimi i kesaj Kontrate behet bazuar ne qellimin e saj dhe jo vetem ne kuptimin e mirefillte te fjaleve.

Neni 13

Publiciteti

Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Palet bien dakord qe çdo njoftim per shtyp, njoftim publik, konfirmim ose informacion tjeter ne lidhje me kete Kontrate ose transakcionet e parashikuara ne te do te behen vetem pasi secila Pale te kete aprovuar me shkrim kohen, formen dhe permbajtjen te çdo informacioni te tille per t'u shperndare paleve te treta ose publikut.

Neni 14

Pajtueshmeria me ligjet

Palet do te respektojne te gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret ne fuqi ne lidhje me performancen e tyre ne baze te kesaj Kontrate.

Neni 15

Marreveshja e plote dhe ndryshimet

Kontrata perfaqeson te gjithe marreveshjen e Paleve per çeshtjen ne fjale dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme, detyrimet, perfaqesimet ose komunikimin e Paleve Kontraktuese, verbale ose te shkruara, ne lidhje me objektin e Kontrates, pervec nese kjo Kontrate parashikon ndryshe.

Nese ndonje autoritet kompetent percakton qe ndonje nga dispozitat e parashikuara ketu eshte e pavlefshme, jo efektive ose e pazbatueshme, kjo dispozite do te konsiderohet e perjashtuar nga kjo Kontrate. Dispozitat e tjera do te mbeten plotesisht te vlefshme dhe efektive, me kusht qe ato nuk



A2021051340019216106

rrjedhin nga dispozita apo permbajtja e saj ose rrethanat nder te cilat dispozita ishte vendosur, ne menyre qe dispozita te mos ndahet nga dispozitat e mbetura ne kete Kontrate. Ne kete rast, Palet Kontraktuese do te kryejne ndryshime, ne menyre qe te arrijne te njejtin efekt ose, nese nuk eshte e mundur, efektin me te afert te mundshem si dispozita e pavlefshme, jo efektive apo qe eshte e pazbatueshme.

Pervec nese kjo kontrate percakton ne menyre te qarte ndryshe, asnje ndryshim nuk do te hyje ne fuqi pervec nese miratohet nga te dyja Palet ne forme te shkruar.

Pervec kur parashikohet ndryshe ne Kontrate, çdo njoftim qe i jepet nga secila Pale, Pales tjetër do te jete me shkrim dhe ne gjuhen shqipe. Njoftimet do te dorezohen me dore ose do te dergohen me poste te regjistruar, ose me poste elektronike ne adresen e selise, ose adresen e postes elektronike te Pales tjetër Kontraktuese.

Kjo kontrate eshte nenshkruar rregullisht nga te dy palet dhe eshte bere ne kater (4) kopje origjinale, ne gjuhen shqipe.

Palet, pasi lexuan me vemendje kete Kontrate, e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe te pavesuar, nenshkruajne si me poshte.

SHITESI:

Redi HAXHI

Redi Haxhi


BASHKESHORTJA E SHITESIT:

Griselda HAXHI

Griselda Haxhi

NOTERE :

Manushaqe H Jaupi



BLERESI:

Ermal SALLAKU

Ermal Sallaku